

FINCA është Institucion Financiar Amerikan, që operon në Euroazi, Lindje të Mesme, Afrikë dhe Amerikë Latine, duke shërbyer mbi 2.8 milion klientë shpall:

FTESË PËR OFERTË

Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë, fton të gjitha Kompanitë e interesuara që të ofertojnë për Tenderin në vijim:

“Auditimi i Pasqyrave Financiare per vitin 2021” me numër të prokurimit FINCA-103/21

Vërejtje:

FINCA Kosovë kërkon kontraktues profesional për të kryer shërbime të auditimi të Pasqyrave Financiare sipas SNRF(IFRS) dhe Rregullave të BQK-së, si dhe Auditimi i Paketës Raportuese sipas SNRF për vitin financiar që përfundon më 31 Dhjetor 2021. Raportet duhet të përgatiten në gjuhën Shqipe dhe Angleze.

Ofertat duhet të jenë të specifikuar në bazë të shërbimeve mëposhtë, gjegjësisht ofertuesit duhet të parashtrijë ofertë të ndarë për secilin prej 3 shërbimeve të cekura në vijim:

1. Çmim te veçantë per shërbime të auditimi të Pasqyrave Financiare sipas SNRF(IFRS) dhe Rregullave të BQK-së si dhe Auditimi i Paketës Raportuese për nevoja të konsolidimit në nivel të grupit sipas SNRF për vitin financiar që përfundon më 31 Dhjetor 2021
2. Çmim te veçantë për shërbime të auditimi të Pasqyrave Financiare sipas SNRF(IFRS) dhe Rregullave të BQK-së për vitin financiar që përfundon më 31 Dhjetor 2021
3. Çmim te veçantë për shërbime Auditimi i Paketës Raportuese për nevoja të konsolidimit në nivel të grupit sipas SNRF për vitin financiar që përfundon më 31 Dhjetor 2021

Kërkesat për ofertat financiare:

- Të gjitha ofertat duhet të dorëzohen në Euro, përfshirë TVSH-në;
- Në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, atëherë do të konsiderohet se çmimet përfshijnë TVSH-në.
- Adresa e plotë dhe detajet kontaktuese të ofertuesit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku deri me 31 Tetor 2021.
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar i kompanisë.
- Ofertës duhet t'i bashkëngjitet Certifikata e Regjistrimit të Biznesit, Certifikata e Regjistrimit si pagues i TVSH-së, Certifikata e Numrit Fiskal dhe kopja e një dokumenti identifikues të pronarit të ndërmarrjes.
- Auditori i jashtëm duhet të ketë së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të bankave apo institucioneve të tjera financiare. Ofertës duhet t'i bashkëngjitet organogrami organizativ i ndërmarrjes – luteni që gjithashtu të ofroni një biografi të shkurtër të ekspertëve apo punonjësve të kualifikuar dhe me përvojë për kryerjen e shërbimeve të kërkuara;
- Ofertës gjithashtu duhet t'i bashkëngjiten tri referenca të lëshuara nga institucione me reputacion të lartë, që konfirmojnë se ofertuesit kanë ofruar shërbime të ngjashme apo kanë kryer në mënyrë të kënaqshme punë të ngjashme me ato të kërkuara me këtë dokument (jo më të vjetra se tri vite).
- Ofertës duhet ti bashkëngjitet licenca për të kryer shërbime auditimi në Republikën e Kosovës.

FINCA Kosovë Zyra Qendrore Rr. Robert Doll, Nr.112 10000 Prishtina + 383 (0) 38-609-721 + 383 (0) 38-609-722 Kosovo.FINCA.org

Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- FINCA Kosovë mban të drejtën për të bërë ndryshimin në specifikacion, të anulojë këtë Tender, të riftojë pjesëmarrësit individual për të riparuar ofertën e tyre, të diskualifikojë një ofertues pa dhënë njoftim apo arsye.
- FINCA Kosovë rezervon të drejtën që për shërbimet e cekura më lartë të angazhojë një apo disa auditorë sipas ofertës.
- FINCA Kosovë dhe ofertuesi fitues do të nënshkruajnë fillimisht kontratë për shërbimin numër 1 të cekur më lartë mirëpo FINCA rezervon të drejtën që fituesin fillestar ta angazhojë vetëm për shërbimin numër 2 sipas ofertës së parashtruar për shërbimin numër 2. Në rast se fituesi fillestar angazhohet vetëm për shërbimin numër 2, atëherë FINCA Kosovë për shërbimin numër 3 do të angazhojë një ofertues tjetër sipas ofertës së parashtruar për shërbimin numër 3.
- Ofertat të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- FINCA Kosovë rezervon të drejtën për të mos kontaktuar me ofertuesit gjatë procesit të tenderimit.
- Asnjë shpenzim që bëhet gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të kompenzohet nga FINCA Kosovë.
- Kriteret për përzgjedhje në këtë Tender bazohen në vendimin e Komisionit për Tender dhe të Bordit Menaxhues.

Oferta duhet të vendoset në zarf të mbyllur dhe të dorëzohet në zyre qendrore të FINCA Kosovës, për Departamentin e Administratës dhe e shënuar qartë me numër të Tenderit në adresën Robert Doll Nr. 112, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Për informata shtesë ju lutemi kontaktoni përmes emailit në: info@fincakosovo.org

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është e premte, 11.06.2021 në orën 16:00.

FINCA Kosovë, Robert Doll 112, 10000 Prishtinë

